

SPECIFIKIMI I TEKNIKE

OBJEKTI: REHABILITIM OBJEKTE INFRASTRUKTURE (PALLATE)

NDERTIMI I ÇATISE

Ndertimi i çatise e matur horizontalisht do të realizohet me lende druri të sharuar e mbështetur mbi trare të sharuar dhe të stazhionuar.

Lenda e drurit do të jetë e stazhionuar në mënyrë natyrale ose artificiale, inprenuar me vaj të djegur të pershtatshëm për lenden e drurit.

Makazet e catise do të jenë 5x3 në çdo 33 cm

Permasat e mahive 10x6 cm largësia e tyre çdo 60 cm

Tjegullat do të jenë të reja betonike importi cilësi e parë, të gozhdura ose të lidhura duke përfshirë lidhjen e ulluqeve horizontale të catise dhe kulmeve duke përdorur llac bastard M-25 të xingato, skelari ose çdo ndryshim tjetër të nevojshëm për ta përfunduar punën.

Në drejtim gjatësor do të vendosen kontroventime me permasa 10x6 cm.

Dalje në çati

Daljet në çati duhet të planifikohen për këto raste:

- Dalje për pastrimin e oxhakëve
- Dalje për heqjen e borës në raste se ajo e rëndon për së tepërmi çatinë dhe e rrezikon mbajtshmërinë e saj.
- Dalje për të bërë ndonjë riparim në çati.

Për objekte me çati duhet paraparë / planifikuar një dalje e sigurtë prej nënçatisë. Kjo dalje duhet të realizohet me anë të një dritareje me përmasa 60 cm x 80 cm, e cila duhet të lidhet mirë me mbulesën e çatisë në mënyrë që të mos kemi rrjedhje të ujit.

Dalja në taracë ose në nënçati duhet të ketë dimensionin: max. 80 x 120 cm.

Me rëndësi është që kapaku i daljes në çati t'i plotësojë kërkesat e mbrojtjes kundër zjarrit si dhe kërkesat e koeficientit të ruajtjes të ngrohjes të tij

PRISHJA E MUREVE TE TULLES

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuar ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdo lloji mjete dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujërave të zeza, ujin, dritat etj.), si dhe vënien mënjandë dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

ULLUKE HORIZONTALE

Realizohen me pjerësi prej 1% për largimin e ujërave. Ulluket horizontale prodhohen me llamarine xingato me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm me të ulët se bordi i brendshëm të kompletuara me pjesë speciale në grykën e hyrjes. Ulluku horizontal i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vena maksimumi në 70 cm.

ULLUKE VERTIKALE

Ulluket vertikale për shkarkimin e ujërave të catise dhe të taracës së banjës

të përgatiten me llamarine prej çeliku të xinguar, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm, kurse ulluket horizontale prej xingato

kane diametër nga 8 deri 12 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe nga 30_60 m².

Në çdo ulluk duhet të mbliqen ujrat e një sipërfaqe catie ose tarrace jo më të madhe se 60 m². Ulluket duhet të vendosen në pjesën jashtme të ndërtesës me anë të qaforeve perkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuara çdo 2 m. Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m duhet të jetë PVC dhe e mberthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehen 90 grade.

MUR TULLE TE PLOTA 25 cm

Muraturë me tulla të plota per parapet ,oxhak,dhe kallkan në lartësi deri 3 m, rëalizohët më llaç bastard m-25, me përmbajtje për m3: tulla të plota nr. 400, llaç bastard m3 0.25, çimento 400, për çdo trashësi muri, si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e nje m3 mur tulle.Muri i parapetit do te kete nje shtrese betoni t=5 cm dhe do te behet me plegmeØ 6 mm hekuri gjate gjithe perimetrit.

Hartoi

Ing Marjana ZHULI

Ing.Sotiraq KOÇA

Ing.Agim TREBICKA